

## Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës:** “Blerje mjete lundrues”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** 34522500-7

**Vlera e fondit limit:** 5,830,000 (pesëmilion e tetëqindetridhjetëmijë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*2.1.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë licensë me kod VII.3.B1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale” dhe nenin 40, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”

Ky kriter është i domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejt me përshtatshmërinë profesionale të operatorit ekonomik për të ushtruar aktivitetin që përbën objektin e kontratës. Kërkesa për një licensë të posaçme që autorizon ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të mjeteve me motor dhe

rimorkiove shërben si provë e drejtpërdrejtë se operatori ekonomik është i regjistruar dhe i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për të zhvilluar këtë veprimtari.

Disponimi i licensës me kod VII.3.B1, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vërteton se operatori ka të drejtë ligjore të kryejë aktivitetin e blerjes dhe shitjes së mjeteve me motor, çka përfshin edhe mjete të ngjashme me karakteristika teknike të përafërta. Kjo kërkesë siguron që subjekti ka kapacitetin profesional dhe eksperiencën e nevojshme për të realizuar furnizimin në përputhje me standardet ligjore dhe teknike. Gjithashtu, vendosja e këtij kriteri ndihmon në shmangien e pjesëmarrjes së operatorëve të paautorizuar, duke rritur besueshmërinë e procedurës dhe cilësinë e realizimit të kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me blerjen e një mjeti lundrues tip gomone, kërkohet që operatori të ketë njohuri dhe aktivitet tregtar të lidhur me mjete motorike, duke garantuar kështu një furnizim të sigurt dhe në përputhje me kërkesat funksionale dhe teknike të autoritetit kontraktor.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 OE duhet te paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

*b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4, gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

*2.3.2 Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të

*veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallit që kërkohet në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtij malli, nisur edhe nga rëndësia dhe specifikat që ka malli objekt prokurimi. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mall sa më cilësor, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohet të blihet e që është prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorit Ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së Operatorit Ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këto mallra është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

Në rastet kur autorizimi paraqitet nga një distributor, kërkesa për të bashkëlidhur dokumentacionin që provon autorizimin e tij nga prodhuesi krijon një zinxhir të plotë dhe të verifikueshëm furnizimi. Ky zinxhir është i rëndësishëm për Autoritetin Kontraktor, pasi mundëson gjurmueshmëri të plotë të produktit, duke garantuar që mjeti lundruar vjen nga burime zyrtare dhe se për të ekzistojnë të gjitha garancitë e nevojshme për cilësi, origjinalitet dhe përputhshmëri me specifikimet teknike të kërkuara.

Përfshirja e të dhënave të plota të prodhuesit, si numri i telefonit, fax-it, email-it dhe faqes zyrtare, është një kërkesë e arsyeshme dhe funksionale, pasi i jep mundësi Autoritetit Kontraktor të kryejë verifikime të drejtpërdrejta në çdo moment gjatë procesit të vlerësimit apo edhe në fazën e zbatimit të kontratës. Kjo rrit transparencën dhe minimizon mundësinë e paraqitjes së dokumenteve të pavërteta apo të manipuluar, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar integritetin e procedurës së prokurimit.

Nga pikëpamja teknike dhe operacionale, ky kriter ndikon gjithashtu në garantimin e shërbimeve pas shitjes, furnizimit me pjesë këmbimi dhe mbështetjes teknike, të cilat janë thelbësore për një mjet lundruar. Vetëm operatorët e autorizuar nga prodhuesi mund të sigurojnë akses në pjesë origjinale dhe në asistencë teknike të certifikuar, çka ndikon drejtpërdrejt në jetëgjatësinë, sigurinë dhe performancën e mjetit gjatë përdorimit.

Vendosja e këtij kriteri është në përputhje me parimet e prokurimit publik për transparencë, konkurrencë të ndershme dhe sigurimin e cilësisë, duke garantuar që Autoriteti Kontraktor të furnizohet me një mjet lundruar autentik, të certifikuar dhe të mbështetur nga prodhuesi ose rrjeti i tij zyrtar.

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponoj një servis në pronësi/me qera/huapërdorje ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/kontratë qiraje/ kontratë huapërdorje të vlefshme jo më pak se afati i garancisë/çdo*

*dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht një servis në pronësi/qira/huapërdorje ose në një formë tjetër të ligjshme përdorimi, përbën një element thelbësor teknik dhe funksional në kuadër të prokurimit të një mjeti lundrues, pasi lidhet me garantimin e mirëmbajtjes, funksionimit të vazhdueshëm dhe sigurisë së mjetit gjatë gjithë ciklit të përdorimit të tij. Duke qenë se mjetet lundruese janë të ekspozuara ndaj kushteve të vështira detare, konsumit mekanik dhe faktorëve korrozivë, ekzistenca e një strukture servisi të dedikuar është e domosdoshme për të siguruar ndërhyrje të shpejta dhe profesionale në rast defektesh apo mirëmbajtjeje periodike. Ky kriter synon të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitetet reale teknike dhe logjistike për të përmbushur detyrimet kontraktuale pas dorëzimit të mjetit, duke përfshirë servisimin, riparimet dhe mbështetjen teknike. Disponimi i një servisi të pajisur dhe funksional redukton ndjeshëm kohën e ndërprerjes së operimit të mjetit dhe rrit efikasitetin operacional të Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton pronësinë, qiramarrjen apo huapërdorjen e këtij servisi siguron një bazë të qartë ligjore mbi të drejtën e përdorimit të tij. Kjo është e rëndësishme për të shmangur situatat kur operatorët deklarojnë kapacitete që nuk i zotërojnë realisht ose që nuk i kanë në dispozicion për një periudhë të mjaftueshme. Kushti që këto dokumente të jenë të vlefshme për një afat jo më të shkurtër se periudha e garancisë garanton vazhdimësinë e shërbimit dhe mbulimin teknik gjatë gjithë kohës kur mjeti është nën përgjegjësinë e operatorit ekonomik.

Në aspektin teknik, një servis i disponueshëm dhe i dokumentuar rrit besueshmërinë e ofertuesit dhe garanton që mirëmbajtja do të kryhet sipas standardeve të kërkuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në jetëgjatësinë e mjetit dhe në ruajtjen e parametrave të tij të performancës. Gjithashtu, ky kriter ndikon në sigurimin e një reagimi të shpejtë në rast avarish, duke minimizuar rreziqet për sigurinë dhe kostot e mundshme shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri garanton që operatori ekonomik jo vetëm furnizon mjetin lundrues, por është edhe në gjendje të sigurojë mbështetje të qëndrueshme teknike dhe operative, në përputhje me kërkesat e kontratës dhe legjislacionin në fuqi.

*2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:*

- *ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit,*

*i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalent të saj përbën një kriter thelbësor teknik dhe organizativ në kuadër të një procedure prokurimi për mjet lundrues, pasi lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë së proceseve që operatori ndjek në furnizim, menaxhim dhe ofrim shërbimesh. ISO 9001:2015 është një standard ndërkombëtar i njohur gjerësisht, i cili përcakton kërkesat për një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë, duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm, kënaqësinë e klientit dhe kontrollin e proceseve operative.

Pajisja me këtë certifikatë dëshmon se operatori ekonomik ka të implementuara procedura të standardizuara dhe të dokumentuara për menaxhimin e aktiviteteve të tij, duke përfshirë furnizimin, kontrollin e cilësisë, trajtimin e ankesave dhe menaxhimin e rreziqeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e furnizimit me mjete lundruese, ku cilësia dhe përputhshmëria teknike e produktit ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përdorimit dhe performancën në kushte reale detare.

Kërkesa që certifikata të jetë e lëshuar nga organizma të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë siguron vlefshmërinë dhe besueshmërinë e saj. Kjo garanton që vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë është kryer nga institucione të pavarura dhe kompetente, duke shmangur rrezikun e certifikimeve formale pa përmbajtje reale apo të pa verifikueshme.

Operatorët që zbatojnë ISO 9001:2015 janë më të aftë të garantojnë kontroll të vazhdueshëm të proceseve, të identifikojnë dhe korrigjojnë devijimet në kohë, si dhe të sigurojnë që produkti i dorëzuar përputhet me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri siguron një nivel të lartë profesionalizmi dhe besueshmërie nga ana e operatorëve ekonomikë, duke garantuar që furnizimi me mjetin lundrues dhe shërbimet e lidhura me të do të realizohen sipas standardeve të njohura ndërkombëtare të cilësisë.

#### *2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë manual përdorimi të mjetit të ofruar.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

*mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë manualin e përdorimit për mjetin lundruar të ofruar lidhet drejtpërdrejt me garantimin e përdorimit të sigurt, korrekt dhe efikas të mjetit nga ana e Autoritetit Kontraktor. Manuali i përdorimit është dokumenti bazë që përmban udhëzimet e detajuara të prodhuesit mbi operimin, mirëmbajtjen, parametrat teknikë dhe kufizimet e mjetit, duke shërbyer si referencë kryesore për personelin që do ta përdorë atë në praktikë.

Disponueshmëria e këtij manuali siguron që përdoruesit të kenë informacion të plotë dhe të saktë mbi mënyrën e funksionimit të mjetit, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e përdorimit të gabuar, i cili mund të çojë në dëmtime teknike apo në rrezikim të sigurisë gjatë lundrimit. Në rastin e mjeteve lundruese, ku ndërveprojnë elementë mekanikë, elektrikë dhe strukturorë në kushte shpesh të vështira detare, njohja e saktë e procedurave të operimit dhe mirëmbajtjes është thelbësore.

Nga pikëpamja teknike, manuali i përdorimit përfshin informacion të rëndësishëm mbi kontrollin para nisjes, përdorimin e motorit, menaxhimin e ngarkesës, procedurat e emergjencës, si dhe mirëmbajtjen periodike. Këto të dhëna ndihmojnë në ruajtjen e performancës optimale të mjetit dhe në zgjatjen e jetëgjatësisë së tij, duke shmangur konsumimin e parakohshëm ose defektet që mund të vijnë si pasojë e përdorimit jo korrekt.

Paraqitja e manualit në fazën e ofertimit i jep gjithashtu mundësi Autoritetit Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e mjetit të propozuar me specifikimet teknike të kërkuara, si dhe të vlerësojë nivelin e detajimit dhe profesionalizmit të dokumentacionit teknik që shoqëron produktin. Kjo rrit transparencën dhe besueshmërinë e ofertës, duke siguruar që mjeti nuk është vetëm në përputhje me kërkesat fizike dhe teknike, por edhe i mbështetur me dokumentacion të plotë nga prodhuesi.

Ky kriter garanton që mjeti lundruar do të shoqërohet me udhëzime të qarta dhe të standardizuara, duke mundësuar përdorim të sigurt, mirëmbajtje të rregullt dhe funksionim të qëndrueshëm në përputhje me kërkesat e kontratës dhe standardet e industrisë.

*2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti është prodhuar në vendet e Bashkimit European ose të jetë prodhuar për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit europiane (CoC).*

**Argumentim:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të

*shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë se mjeti lundruer është prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose është prodhuar për përdorim në vendet e BE lidhet me garantimin e përputhshmërisë së produktit me standardet europiane të sigurisë, cilësisë dhe performancës.

Ky kriter siguron që mjeti i ofruar është projektuar dhe prodhuar sipas kërkesave të rrepta të tregut europian, ku normat teknike dhe rregullat e sigurisë për mjete lundruese janë të qarta dhe të detajuara.

Paraqitja e deklaratës së operatorit ekonomik, e shoqëruar me certifikatën e konformitetit europiane (CoC), siguron një bazë të verifikueshme ligjore dhe teknike për origjinën dhe përputhshmërinë e mjetit. Certifikata CoC dëshmon se mjeti plotëson kërkesat e Bashkimit Europian për dizajn, materialet e përdorura, proceset e prodhimit dhe sigurinë gjatë operimit, duke garantuar që produkti mund të përdoret në mënyrë të ligjshme dhe të sigurt në territorin e BE-së dhe përputhet me standardet e kërkuara për kategori të ndryshme lundrimi.

Ky kriter është i rëndësishëm edhe nga pikëpamja e besueshmërisë së furnizuesit dhe cilësisë së mjetit, pasi prodhimi në vende të BE-së shpesh lidhet me kontrole të rrepta të cilësisë, auditime të vazhdueshme dhe përdorim të materialeve të certifikuara. Ai gjithashtu mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë verifikime të thjeshta dhe të shpejta mbi dokumentacionin teknik, duke siguruar që mjeti është i përputhshëm me specifikimet dhe kërkesat ligjore.

Në aspektin teknik dhe operativ, përputhshmëria me standardet europiane garanton që mjeti lundruer do të ketë performancë të qëndrueshme, jetëgjatësi dhe siguri operimi edhe në kushte të ndryshme detare. Në këtë mënyrë, kriteri i paraqitjes së deklaratës së origjinës së mjetit dhe certifikatës CoC është i justifikuar, pasi siguron një nivel të lartë cilësie, besueshmërie dhe transparence në procesin e prokurimit.

*2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën mbi direktivat europiane që garanton standartin europian 2013/53/UE mbi normat e certifikimit CE.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë certifikatën mbi direktivat europiane, e cila garanton përputhshmërinë me standardin 2013/53/UE dhe normat e certifikimit CE, është një kriter thelbësor teknik dhe ligjor në kuadër të prokurimit të mjeteve lundruese. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, cilësinë dhe përputhshmërinë ligjore të mjetit, duke garantuar që ai është projektuar, prodhuar dhe testuar sipas kërkesave të Bashkimit European për mjete lundruese, përfshirë parametrat strukturore, mekanikë dhe të sigurisë për përdoruesit.

Certifikata CE e lëshuar sipas direktivës 2013/53/UE dëshmon që mjete ka kaluar kontrole të rrepta të konformitetit dhe përmbush standardet e detajuara për kategoritë e ndryshme të lundrimit, duke përfshirë qëndrueshmërinë, flotacionin, motorizimin, stabilitetin dhe sigurinë në rast emergjencash. Kjo siguron gjithashtu që mjete mund të përdoret ligjërisht dhe në përputhje me rregullat e standardizimit european, duke eliminuar rreziqet e përdorimit të produkteve të pa certifikuar ose të pasigurta.

Nga pikëpamja teknike dhe operationale, paraqitja e kësaj certificate i ofron Autoritetit Kontraktor një bazë të verifikueshme dhe të dokumentuar për cilësinë dhe sigurinë e mjetit. Ajo lejon kontrollin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet e kontratës dhe standardet ndërkombëtare, duke garantuar që performanca e mjetit lundrues nuk do të komprometohet nga defekte të prodhimit apo mosrespektim i normave teknike.

Në tërësi, ky kriter është i justifikuar si teknikisht, ashtu edhe ligjërisht, pasi siguron që mjete i ofruar plotëson kërkesat më të larta europiane të sigurisë dhe cilësisë, duke rritur besueshmërinë e ofertuesit dhe sigurinë operationale të Autoritetit Kontraktor gjatë përdorimit të mjetit lundrues.

### 2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklarinimin e fuqisë së motorit.

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”* dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklarinimin e fuqisë së motorit për mjetin lundrues është një kriter thelbësor teknik, pasi fuqia e motorit është një parametër kryesor që përcakton performancën, manovrueshmërinë, shpejtësinë dhe sigurinë operative të mjetit. Ky deklarinim lejon

Autoritetin Kontraktor të verifikojë që motorizimi i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të tenderit, duke siguruar që mjeti do të funksionojë siç pritet edhe në ngarkesë të plotë dhe në kushte detare mesatare, pa rrezikuar stabilitetin ose sigurinë e përdoruesve.

Prezantimi i fuqisë së motorit sipas dokumentacionit të prodhuesit ose të testeve të certifikuara siguron gjithashtu që parametrat deklaruar nuk janë vetëm teorikë, por janë të bazuar në të dhëna të verifikueshme, duke ofruar transparencë dhe besueshmëri për Autoritetin Kontraktor. Ky dokument është i nevojshëm për të përcaktuar kapacitetin e mjetit për planim, reagim në emergjencë dhe përdorim efektiv në operacione patrullimi, transporti apo shërbime të tjera.

Deklarimi i fuqisë së motorit ndihmon në planifikimin e mirëmbajtjes, përshtatjen e pjesëve rezervë dhe kontrollin e performancës gjatë përdorimit. Ai gjithashtu ofron një bazë për vlerësimin e konsumit të karburantit dhe efikasitetit të mjetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në kostot operative dhe sigurinë gjatë eksplotimit.

Ky kriter garanton që mjeti lundruar është i pajisur me motorizim të përshtatshëm dhe i verifikueshëm, duke mbështetur performancën e sigurt, operimin efektiv dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike të kontratës.

*2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 2 vite.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë garancie, ku përcaktohet se periudha e garancisë është jo më pak se 2 vite, është një kriter thelbësor teknik dhe ligjor në kontekstin e prokurimit të mjeteve lundruese. Ky kriter siguron mbrojtje për Autoritetin Kontraktor ndaj defekteve të mundshme të prodhimit, problemeve teknike ose materialeve të dobëta gjatë përdorimit të mjetit. Një periudhë garancie minimale dyvjeçare garanton që operatori ekonomik është i përkushtuar të mbulojë riparimet, zëvendësimet ose ndërhyrjet teknike që mund të lindin

brenda këtij afati, duke siguruar funksionimin e vazhdueshëm dhe performancën e deklaruar të mjetit.

Deklarata e garancisë shërben gjithashtu si dokument i verifikueshëm ligjor, që lejon Autoritetin Kontraktor të ushtrojë të drejtat e tij në rast defektesh ose mosfunksionimi, duke minimizuar rreziqet financiare dhe operacionale të lidhura me investimin. Përveç aspektit ligjor, ky dokument ka rëndësi teknike, pasi ai detyron operatorin ekonomik të sigurojë cilësi të lartë prodhimi dhe të ndjekë standardet e mirëmbajtjes së mjetit gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Nga pikëpamja operacionale, garancia dyvjeçare ofron Autoritetit Kontraktor siguri se mjeti lundruar do të ruajë performancën, stabilitetin dhe funksionalitetin e parashikuar, duke mbështetur operacione të sigurta dhe të efektshme në ujëra bregdetare apo kushte detare mesatare. Në këtë mënyrë, kërkesa për deklaratë garancie është e drejtë, e arsyeshme dhe tekniko-operacionale e domosdoshme, pasi siguron mbrojtje të përdoruesit, standarde të larta cilësore dhe besueshmëri të produktit gjatë gjithë ciklit të jetës së tij.

#### *Specifikimet teknike të mjetit:*

Mjeti lundruar i kërkuar duhet të ketë gjatësi nga 6 deri në 6.5 metra dhe gjerësi nga 2.5 deri në 3 metra, me dimension tubolari nga 55 deri në 60 cm.

Ai duhet të ketë kapacitet transporti prej 12 deri në 16 personash në bord dhe peshë maksimale deri në 1 ton.

Motorizimi duhet të jetë në intervalin 140 deri në 175 HP, me motor të jashtëm, duke garantuar performancë të lartë dhe mirëmbajtje të thjeshtuar.

Mjeti duhet të jetë i pajisur me certifikim CE, Kategoria C, në përputhje me standardet europiane të sigurisë për lundrim në ujëra bregdetare dhe kushte mesatare detare.

Tubularët duhet të jenë të materialit Hypalon Neoprene Orca, ndërsa trupi i mjetit duhet të jetë prej vetrozine (fiberglass), për të siguruar qëndrueshmëri, rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe jetëgjatësi në përdorim.

Mjeti lundruar duhet të jetë i papërdorur.

Specifikimet e përcaktuara për mjetin lundruar përfaqësojnë një zgjidhje të balancuar teknikisht, e cila synon të garantojë siguri, performancë dhe qëndrueshmëri në përdorim. Gjatësia prej 6 deri në 6.5 metra, e kombinuar me një gjerësi prej 2.5 deri në 3 metra, krijon një raport optimal për stabilitet dhe manovrueshmëri, duke e bërë mjetin të përshtatshëm si për lundrim në zona bregdetare ashtu edhe për operime në hapësira të kufizuara si porte apo gjire. Këto përmasa sigurojnë gjithashtu hapësirë të mjaftueshme për transportin e personave dhe pajisjeve pa ndikuar negativisht në performancën e mjetit.

Diametri i tubularëve në intervalin 55 deri në 60 cm kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e flotacionit dhe stabilitetit, veçanërisht në kushte ngarkese të plotë. Kjo përmasë rrit sigurinë gjatë lundrimit duke siguruar rezervë të mjaftueshme notueshmërie dhe duke ndihmuar në amortizimin e goditjeve nga dallgët. Në të njëjtën kohë, kapaciteti për 12 deri në 16 persona dhe pesha maksimale deri në 1 ton janë në përputhje me dimensionet dhe karakteristikat strukturore të mjetit, duke mundësuar një shpërndarje të balancuar të ngarkesës dhe funksionim efikas në kushte operative të ndryshme. Motorizimi i parashikuar në intervalin 140 deri në 175 HP me motor të jashtëm siguron një raport të favorshëm fuqi-peshë, i cili mundëson arritjen e shpejtë të planimit dhe ruajtjen e një shpejtësie operative optimale edhe në ngarkesë të plotë. Zgjedhja e motorit të jashtëm përmirëson ndjeshëm

mirëmbajtjen, pasi lehtëson aksesin për servis dhe redukton kostot operative, duke rritur njëkohësisht besueshmërinë në përdorim afatgjatë.

Pajisja me certifikim CE, Kategoria C, garanton përputhshmërinë me standardet europiane të sigurisë dhe ndërtimit, duke e bërë mjetin të përshtatshëm për lundrim në ujëra bregdetare dhe kushte detare mesatare. Ky certifikim është thelbësor për përdorim profesional dhe institucional, pasi siguron që mjeti përmbush kërkesat për stabilitet, qëndrueshmëri dhe siguri.

Përdorimi i materialit Hypalon Neoprene Orca për tubolarët siguron rezistencë të lartë ndaj rrezeve ultraviolet, kripës dhe kushteve atmosferike, duke garantuar jetëgjatësi dhe performancë të qëndrueshme edhe në përdorim intensiv. Ndërkohë, ndërtimi i trupit prej vetrozine ofron një strukturë të fortë dhe rezistente ndaj goditjeve, me peshë të optimizuar dhe kërkesa të ulëta për mirëmbajtje, duke e bërë mjetin të përshtatshëm për operime afatgjata në mjedis detar.

Kërkesa që mjeti lundruar të jetë i papërdorur justifikohet nga nevoja për të garantuar performancë optimale, besueshmëri të lartë dhe jetëgjatësi maksimale të pajisjes. Mjetet e papërdorura nuk kanë konsumim të komponentëve strukturorë dhe mekanikë, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e defekteve të hershme, ndërprerjeve operacionale dhe kostove të paparashikuara të mirëmbajtjes. Gjithashtu, ato përmbushin standardet më të fundit teknike dhe të sigurisë, si dhe vijnë me garanci të plotë nga prodhuesi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për operacione që kërkojnë siguri të lartë, efikasitet dhe përputhshmëri me rregulloret aktuale detare. Në tërësi, këto specifikime teknike sigurojnë një mjet lundruar të besueshëm, efikas dhe të sigurt, i cili përmbush kërkesat për performancë, kapacitet dhe qëndrueshmëri në përputhje me standardet bashkëkohore europiane.

Afatet e lëvrimit: 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. Ky afat është vlerësuar si i mjaftueshëm për realizimin e kontratës me sukses nga operatori ekonomik i suksesshëm.

Specifikimet teknike janë hartuar nga sektori i transportit dhe logjistikës dhe përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## **NJËSIA E PROKURIMIT**